Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY

132/17
09.06.17

PSH Nr. 132/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z.Goran Milenković - Kryetar, z.Tefik Sulejmani - Referues, - z. Nuhi Paçarizi Anetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE ankues "Buli Medical"- Prishtinë, kundër vendimit per Anulim të Vendimit per dhenie te kontrates të AK–/Spitali i pergjithshem Gjilan/, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me reagenca per Olimpus –Lot l" me nr. prokurimi:"702/17/04/121", më datën 01.06.2017 mori këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet** , si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Buli Medical"- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me reagenca per Olimpus –Lot l" me nr. prok. 702/17/04/121, iniciuar nga AK-/ Spitali i pergjithshem Gjilan /.

II. **Vertetohet ,** vendimi për anulim AK-së / Spitali i pergjithshem Gjilan / lidhur me aktivitetin të prokurimit, me titull: "Furnizim me reagenca per Olimpus –Lot l" me nr. prok. 702/17/04/121,

III. Autoriteti Kontraktues në afatë prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me ketë ligj;

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Buli Medical"- Prishtinë refuzohet si e pa bazuar, i konfiskohet tarifa e ankesës konform nenit 33.5 në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Autoriteti Kontraktues-Spitali i Pergjithshem Gjilan ka bërë shpalljen e Njoftimit për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit me dt: 15.02.2017.

Dorëzimi dhe Hapja e ofertave është bërë me dt: 09.03.2017, ku kanë marr pjesë pese operatorë ekonomik.

AK-Spitali i Gjilanit, ka caktuar komisionin për vlerësimin e tenderëve në përbërje prej 3(tre) antarëve te cilet kanë filluar dhe mbaruar vlerësimin me dt.25.04.2017.

Njoftimi për anulim lidhur me aktivitetit të prokurimit në fjalë është bërë me dt:25.04.2017.

Kundër njoftimit për anulim te Aktivitetit te prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit ne fjalë, operatorin ekonomik "Buli Medical" - Prishtinë, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik "Buli medical" - Prishtinë, për rishqyrtim të njoftimit për anulim Autoriteti Kontraktues me dt:02.05.2017 ka marr vendim me te cilin ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

Operatori ekonomik "Buli Medical" - Prishtinë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më dt.04 maj 2017 me nr. 132/17, kundër njoftimit për anulim me titull: "Furnizim me reagenca per Olimpus –Lot l" me nr. prok. 702/17/04/121", duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 6 i LPP-së –Ekonomiciteti dhe efikasiteti
- Neni 7 i LPP-së –Barazia ne trajtim
- Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni108/A i LPP-së- Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, me dt.10.05.2017 ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues përmes raportit të datës 18 maj 2017, propozon panelit shqyrtues që aktiviteti i prokurimit me titull "Furnizim me reagenca per Olimpus –Lot I" me nr. prok. 702/17/04/121", të kthehet në Rivlerësim, ndërsa ankesen e operatorit ekonomik "Buli Medical" - Prishtinë ta aprovojë si të bazuar.
Autoriteti Kontraktues me datë: 22 maj 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.
Operatori Ekonomik me date: 22 maj 2017, me ane te parashtreses, ka njoftuar OSHP-ne, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 01.06.2017, ku kanë qenë prezent anëtarët e panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, përfaqësuesit e palëve në procedurë, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi per anulim te aktivitetit te prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues "Buli medical" z.Rashiti ka deklaruar se:
Per shkak se ne oferten e kerkuar nga AK-ja eshte kerkuar cmimi per nje ml dhe nuk eshte kerkuar cmimi per pako ose kod paketimi. Kershtu qe ne kemi vepruar edhe e kemi permbushur me ml.
Andaj kërkojmë nga paneli shqyrtues të OSHP-së të aprovoj ankesën tonë, të marr vendim për anulim të vendimit për anulim, dhe tenderi jonë të shpallet i përgjegjshëm dhe aktiviteti i prokurimit tender për furnizim me reagensa per olimpus të kthehet në Rivlerësim.

Gjatë prezantimit në seancë në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të AK-SP-Gjilan z.Sylejmani i cili deklaroj: eshte e vertet cka u deklarua nga OE eshte kerkuar cmimi ne ml mirepo ka pasur mangesi ne specifikim dhe kjo ka qene arsyeja kryersore qe e kemi anuluar. Sa per deshmi per Panelin kam sjell nje kuti transportuese e cila ne vehte permban numrin e bocave te cilat jane te mbushura me sasit e mililitrave. Psh, nje produkt AST-ja, permban ne vehte kater boca nga 6 Ml dhe 4 tjera prap nga 6 ml. ne specifikim eshte dhene kodi mirepo leshimi eshte se nuk eshte dhene sasi per Brenda dhe ky ka qene leshimi nga ana jone. Nje reagenc pa i pasur 4 lloje nuk mundet me funksionu laboratori.

Në vazhdim fjala iu dha ekspertit shqyrtues z.Fazliu i cili deklaroj: fillimisht duhet te sqaroj se ate cka deklaroj perf. i AK-se, komisoni vleresues dhe zyrtari kryesor nuk ka bere anulimin e aktivitetit me arysetimin se kemi gabime teknike ne paramas sic u deklarua tani por aryetimi ka qene se eshte tejkaluar buxheti i parashikuar. Dua ta rekomandoj AK-ne se ne rast se eshte e mundur te paraqitet ne paragrafat e kontrates ne lidhje me kete aktivitet te prokurimit nese ekziston i njeti arsyetim cka edhe deklaraoj ne seanc, por ne pramas kerkesa ka qene qe te ofrohet ne ML dhe te njetjen e ka bere OE ankues.

Ne pyetjen e antarit te panelit se a mundet te permbyllet ky aktivitet me keto kerkesa te dosjes se tenderit, ne pergjigje perfaqesuesi i AK-se deklaroj se nuk mund te permbyllet me kete specifikim teknik.
Nese per tri vite ka qene me ml pse tani nuk mund te merren edhe kete vit ne ml.

Ne fjalen perfunditamre perfaqesuesi i AK-se, po te anulohet ky aktiviet do te shkoj me ml dhe do te jepen informata me te detajuara dhe kekojme qe te refuzohet ankesa e OE ankues dhe te aprovohet vendimi i AK-se.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues të cekur në ekspertizë, parashtresës së AK-së, deklarimit te OE ankuese ne seanc lidhur me ekspertizen, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton se Ankesa e Operatorit Ekonomik eshte e pa bazuar pasi qe AK- /Spitali i pergjithshem Gjilan/,me rastin e vlersimit te ofertave lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:"Furnizim me reagenca per Olimpus –Lot l" me nr. prokurimi:"702/17/04/121" nuk ka vepruar konform nenit 59 dhe 62 të LPP-së, per shkak se AK me rastin e hartimit te dosjes se tenderit kane leshuar gabime ne specifikacion teknik, te cilat kane qene te pamundura te rregullohen apo parandalohen ne fazen e vlersimit te ofertave, perveq permes procedures se ri tenderimit te ketije aktiviteti.

Prandaj Paneli shqyrtues, duke u bazuar në nenin 117 të LPP-së, si dhe duke u mbështetur në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran MILENKOVIĆ

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Spitali i pergjithshem Gjilan"

1x1 OE – "Buli Medical" - Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në ëeb- faqe të OSHP-së.